

VENDIM
Nr.758, datë 15.9.2010

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT, SI DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËTIJ BORDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përzgjedhja e katër anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga sektori ekonomik privat, bëhet me anë të konkurrimit.
 2. Procedurat e konkurrimit bëhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe pas njoftimit në mediat e shkruara dhe elektronike.
 3. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për në bordin drejtues janë këto:
 - Të përfaqësojë një sektor të rëndësishëm të biznesit;
 - Të jetë personalitet i njohur dhe aktiv në sektorin e biznesit të cilin përfaqëson;
 - Të ketë përvojë drejtuese jo më pak se 7 (shtatë) vjet në fushën e sektorit që përfaqëson;
 - Të ketë përvojë pune jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) vjet në sektorin privat;
 - Të rekomandohet, me shkrim, nga organizatat e biznesit për të qenë anëtar në bordin drejtues;
 - Të mos jetë i dënuar penalisht;
 - Të mos ketë detyrime ligjore ose proces gjyqësor ndaj tij.
 4. Shpërblimi i anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve është 5000 (pesë mijë) lekë në muaj dhe përballohet nga buxheti i kësaj agjencie.
 5. Ministri përgjegjës për ekonominë emërohet nënkryetar i bordit drejtues.
 6. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha